

VENDIM
Nr.656, datë 28.9.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I SEGMENTIT
RRUGOR FUSHË-KRUJË-MILOT DHE I RRUGËVE DYTËSORE TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.10 450, datë 14.7.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e të vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i segmentit rrugor Fushë-Krujë-Milot dhe i rrugëve dytësore të tij.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen, tokë arë, prej 17 213 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e trembëdhjetë) m², me vlerë 7 094 991 (shtatë milionë e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një) lekë, për truallin, me sipërfaqe 1 158 (një mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) m², me vlerë 2 350 970 (dy milionë e treqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë, për objekte, me vlerë 43 011 802 (dyzet e tre milionë e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e dy) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 52 457 763 (pesëdhjetë e dy milionë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 697 000 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 52 457 763 (pesëdhjetë e dy milionë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2011, “Zëri investime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

6. Pronari i pasurisë, për të cilën është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja+leje ndërtimi”, të kompensohet, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë, si dhe atij tekniko-ligjor.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Shpronësimi të fillojë më 30.9.2011 dhe të përfundojë më 30.12.2011.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat janë bërë shënimet përkatëse “Konfirmuar nga ZVRPP-ja+leje ndërtimi” dhe “Konfirmim nga ZVRPP-ja”, në bazë të pikave 6 dhe 7 të këtij vendimi.

10. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Krujë dhe Kurbin, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit.

11. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Krujë dhe Kurbin, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Krujë dhe Kurbin, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha